



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Mirësi Org. Org. Jedm. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
01	15
Nr. efaqeve Tirëz. Stranica No. pages	Data Datum Date
03	24.05.2012
PRISHTINË/A	

Ministria e Punëve të Brendshme
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
 Ministry of Internal Affairs

POLICIA E KOSOVËS - KOSOVSKA POLICIJA	
DREJTORIA E PËRGJITHSHME	
GENERALNA DIREKTORIJA	
Ref. DPPK-01/0542/2012	
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	
KANCELARIJA GENERALNOG DIREKTORA	

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate

dhe

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
 Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
 National Agency for personal Data Protection

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR MBËSHTETJE DHE BASHKËPUNIM

LIDHUR NË MES TË:

POLICISË SË KOSOVËS - të cilën e përfaqëson Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni

dhe

AGJENCISË SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE - të cilën e përfaqëson z. Ruzhdi Jashari

I. PËRMBAJTJA (QËLLIMI) I MEMORANDUMIT

Bashkëpunimi ndërinstitucional i palëve në memorandum, me qëllim të ofrimit të mbështetjes nga ana e Policisë së Kosovës për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të fushëveprimtarisë së saj, me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konform dispozitave të Ligjit për Policinë,

II. PALËT NËNSHKRUESE TË MEMORANDUMIT U PAJTUAN MBI DREJTAT DHE OBLIGIMET

Obligimet e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

1. Parashtrimi dhe arsyetim i kërkesës me kohë për nevojën e asistimit të zyrtarëve policorë me rastin e zhvillimit të inspektimit dhe kontrollit të subjektet kontrolluese, në rastet e konfiskimit të dokumenteve zyrtare, pajisjeve harduerike, softuerike dhe materialeve tjera që mund të konfiskohen në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave Personale.
2. Kërkesa të parashtrohet kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose personave në kryerjen e detyrave publike mund të rrezikohet nga rezistimi i mundshëm ndaj veprimeve të tyre.

Obligimet e Policisë së Kosovës:

1. Asistimi-ofrimi i ndihmës zyrtarëve të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kryerjen e detyrave publike:
 - Në rastet kur ka arsye për tu besuar se siguria e personit ose personave në kryerjen e detyrave publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm, dhe;
 - Në rastet kur, sipas vlerësimit të njësisë përkatëse të PK-së, ka mundësi operacionale për realizimin e kërkesës për asistim-ndihmë.

III. Mosmarrëveshjet Eventuale

Palët pajtohen që për çdo mosmarrëveshje apo keqinterpretim lidhur me qëllimin dhe obligimet e palëve, ato të zgjidhen përmes bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellë.

IV. Vlefshmëria Kohore e Marrëveshjes

Palët nënshkruese pajtohen që vlefshmëria kohore e kësaj marrëveshjeje të jetë dy (2) vite, me mundësi vazhdimi dhe ndryshimi në përmbajtje të saj, sipas marrëveshjes paraprake me shkrim në mes të dy palëve.


V. Kopjet e Marrëveshjes

Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Nënshkruar më 23-05-2012 në PRISHTINË.

PËR POLICINË E KOSOVËS:

Drejtori i Përgjithshëm i PK-së,
z. Shpend MAXHUNI



**PËR AGJENCINË SHTËTËRORE
PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE**

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror
z. Ruzhdi JASHARI

